

SHPIRTI, EGOJA DHE ZEMRA SIPAS KURANIT

Përmes një leximi sipërfaqësor të Kuranit, mund të shihet qartë se njeriu ka një pozicion të veçantë në univers. Ai në skemën e përgjithshme të Uuniversit, që në zanafillë është krijuar i tillë, për të qenë ndryshe nga krijesat tjera. Ky ndryshim është i theksuar në shumë vende në Kuran, ndërsa një përshkrim tipik për këtë mund të shihet më së miri nga ajo që është përmendur në suren El-Hixhr:

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë do të krijoj një njeri prej baltës së thatë të marrë nga balta e zezë pa formë. Kur t'i jap formën dhe t'i fryj prej ruhut (shpirtit) të krijuar prej Meje, ju t'i përuleni atij në sexhde”.

(Kuran, 15:28-29)

Procesi i krijimit, siç është përshkruar në tekstin kuranor, kuptohet qartë se ka qenë i tëri i planifikuar paraprakisht (jo aksidental), ka rrjedhur si rezultat i vullnetit të Krijuesit dhe është realizuar në një moment të veçantë. Ky ndryshim ka ndodhur që në fazën e parë të krijimit të njeriut, gjegjësisht kur elementi hyjnor është futur në brendësinë e njeriut përmes frymimit nga Krijuesi, i quajtur *ruh* (shpirt), përmes së cilit është kompletuar i gjithë procesi i krijimit të qenies njeri.

Pra, koncepti i parë i natyrës së brendshme të njeriut është ai i shprehur përmes termit *ruh* – shpirt. Çfarë është *ruh-u*? Kjo pyetje është ngritur edhe në kohën e Muhamedit (a.s.), kurse përgjigja për këtë ka ardhur nga teksti i shpallur kuranor:

“Të pyesin ty (o Muhamed) për shpirtin. Thuaj: Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni”.

(Kuran, 17:85)

Nga ky ajet nënkuptohet se kuptimi i detajuar i natyrës së *ruh-ut* nuk është i mundur. Sido që të jetë, në pjesët e tjera relevante të Kuranit, të cilat e përshkruajnë procesin e krijimit, mund të nxirren më shumë kuptime rreth termit *ruh*.

Përveç ajeteve të sures El-Hixhër, të cituara më lart, procesi i krijimit të njeriut është përshkruar në pjesë tjera të Kuranit si:

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: – Unë do të krijoj një mëkëmbës në Tokë-, ata thanë: – A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?! Ai tha: – Unë di atë që ju nuk e dini. Allahu ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje, pastaj ua paraqiti engjëjve dhe u tha: – Më tregoni emrat e tyre, nëse ajo që thoni është e vërtetë!. – Qofsh i lavdëruar! – thanë ata, – ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti. – O Adem, – tha Ai, – ua trego atyre emrat e gjërave! Kur ai ua tregoi emrat e tyre, Allahu tha: – A nuk ju kam thënë se vetëm Unë i di fshehtësitë e qiejve e të Tokës dhe vetëm Unë e di çfarë tregoni haptazi dhe çfarë fshihni?! Kur u thamë engjëjve: “Përluni në sexhde para Ademit”, – ata u përlunë, përveç Iblisit, i cili nuk desh, u tregua arrogant dhe u bë mohues”.

(Kuran, 2:30-34)

Ajo që është e përbashkët në këtë përshkrim është tregues se natyra njerëzore ka një element qenësor, dhe jo vetëm për nga pozita e lartë që zë në mesin e krijesave, por edhe për nga fakti se njeriu që nga fillimi është dizajnuar që të zërë vend në tokë si mëkëmbës dhe mirëmbajtës i rregullit në tokë.

Kur për herë të parë u është kumtuar lajmi për engjëjt, se njeriu është krijuar dhe është caktuar që të jetë përgjegjës – mëkëmbës në tokë, reagimi i parë i tyre ishte frikësimi nga çrregullimet që mund të shkaktohen në tokë.

“... A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty”?!

(Kuran, 2: 30)

Ky ishte ndryshimi i parë dallues nga krijesat tjera, ndërsa ajo që e karakterizon këtë ndryshim është frymimi i Zotit në strukturën e krijuar të Ademit (a.s.) (nga shpirti i Tij). Kjo është referuar edhe në suren El-Bekare, ajeti 31, kur Krijuesi i dha dije e njohuri Ademit (a.s), të cilën nuk e ndau as me engjëjt dhe as me ndonjë krijesë tjetër.

“Allahu ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje, pastaj ua paraqiti engjëjve dhe u tha: – Më tregoni emrat e tyre, nëse ajo që thoni është e vërtetë! – Qofsh i lavdëruar! – thanë ata, – ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti”.

Është me rëndësi që të përmendet në këtë kontekst edhe kërkesa që iu është bërë engjëjve nga Zoti që t’i përulën Ademit (a.s.) pas krijimit të tij.

Pajisja e njeriut me dije, si dhe të qenit e tij si recipient – pranues i elementit hyjnor *ruh*, janë cilësi të cilat njeriun e kanë ngritur nga origjina e tij modeste dhe i kanë mundësuar atij që të tejkalojë pjesën bazike të natyrës së tij, duke e bërë të përshatshëm për të qenë edhe mëkëmbës i Krijuesit në tokë – *kalif*.

Atëherë çfarë është *ruh*?

Ndoshta mund të thuhet se *ruh* është një aftësi speciale për sigurimin e njohurive, sepse *ai* është referuar disa herë në Kuran si i ardhur nga vetë Krijuesi. *Ruh*-u është një aftësi e cila i është bashkangjitur njeriut pasi është plotësuar krijimi i tij biologjik dhe fizik.

Kjo shihet qartë në suren El-Bekare, ajetet 30-34.

Pjesa e dytë, ka të bëjë me diturinë e dhënë Ademit (a.s.) dhe dialogun e tij me engjëjt (Kuran, 2:31). Engjëjt e kuptuan kufizimin e tyre mbi njohurinë (Kuran, 2:32):

“Qofsh i lavdëruar, – thanë ata, – ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti”.

Prandaj, pranimi i superioritetit të Ademit (a.s.) nga ana e engjëjve i bëri ata që edhe t’i përulën njeriut në momentin e parë të formësimit të tij. Shumë interesante janë edhe fjalët të cilat janë përdorur për të përshkruar njeriun e parë, kur në dallim nga

qeniet tjera të gjalla, atij i është dhënë fuqia e dijeve-njohurive, të cilat nuk kanë qenë të kufizuara në numër dhe në sasi. Pra, Ademiti (a.s.) i është dhënë dija e tërësisë së gjërave (*Allahu ia mësoi Ademiti emrat e çdo gjëje*), që nënkupton një potencial të pakufizuar të njohurive, ndërsa engjëjt në bazë të tekstit kuranor e kishin pranuar që në fillim kapacitetin e kufizuar të tyre në dije. Engjëjve sipas shpjegimit kuranor u janë ofruar njohuri të cilat kanë qenë specifike vetëm për ta, kurse njeriut të parë i është dhënë aftësia e gjenerimit të njohurive, gjë e cila nuk i është dhuruar edhe ndonjë krijese tjetër në tokë.

Një karakteristikë tjetër e shoqëruar me *ruh*-un është edhe ndjenja për njohjen e Zotit si fuqi absolute. Kjo karakteristikë është e shprehur qartë në Kuran:

“Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademiti pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë ndaj vetes së tyre, u tha: – A nuk jam Unë Zoti juaj? Ata iu përgjigjën: – Po, dëshmojmë se Ti je. Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: – Këtë nuk e kishim ditur”.

Kërkesa për njohjen e Zotit mund të mos jetë në formë direkte për njeriun gjatë gjithë herëve. Mirëpo, sido që të jetë, Kurani tregon se në thellësinë e psikikës së njeriut kjo ndjenjë për njohjen e Zotit është e evidente, e cila madje aktivizohet edhe te njerëzit e deklaruar si jobesimtarë, sidomos në rastet e krizave të tensionuara, përmes së cilave ata mund të kalojnë dhe të ballafaqohen në jetën e tyre.

“Thuaju: Kush ju shpëton nga errësira e tokës dhe e detit, kur i luteni Atij haptazi dhe fshehurazi. Nëse Ai na shpëton prej këtyre (rreziqeve), vërtet do të bëhemi mirënjohës”.

(Kuran, 6:63)

II

Përderisa shpirti (*ruh*) shihet si element qiellor te njeriut, zemra (*kalb*) besohet të jetë agjenci operuese e psikikës, e cila e transformon potencialin shpirtëror në aktualitet. Një karakteristikë tjetër e rëndësishme e zemrës është, po ashtu, edhe mundësia që ajo i jep personit për të ditur dhe kuptuar realitetin e gjërave, si dhe aftësinë për të gjykuar dhe për të dalluar të mirën nga e keqja.

Funksionet e zemrës në Kuran janë përshkruar disa herë. Nëse funksionimi i zemrës është i bllokuar, atëherë edhe organet më të ulëta të ndijimit humbin aftësinë e tyre. Në këto raste njerëzit kanë sy me të cilët nuk shohin dhe veshë me të cilët nuk dëgjojnë.

“Ne kemi paracaktuar për Xhehenemin shumë xhinde dhe njerëz, sepse ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më keq. Pikërisht këta janë të shkujdesurit”.

(Kuran, 7:179)

Zemra është një organ i brendshëm, i cili perceptimeve të të dëgjuarit u jep kuptim.

Një rol i zemrës në këtë drejtim është përshkruar në pjesë të ndryshme të Kuranit, si më poshtë:

Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove – ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh.

(Kuran, 2: 6-7)

Kështu ua vulos Allahu zemrat mohuesve.

(Kuran, 7-101)

...Allahu ua vulosi ato (zemrat) e pak prej tyre janë që besojnë.

(Kuran, 4:155)

... ata besuan (me gojë) e pastaj mohuan, andaj zemrat e tyre u mbyllën dhe ata nuk kuptojnë...

(Kuran, 63: 3)

Këta janë ata të cilëve Allahu ua ka vulosur zemrat, të dëgjuarit dhe të parët; pikërisht këta janë të shkujdesurit.

(16-108)

Në një hadith (thënie) të Muhamedit (a.s.), zemra është përshkruar me fjalët:

“Keni kujdes! Në trupin e njeriut është një copë mishi (pra, zemra). Nëse kjo copë mishi është e shëndoshë, atëherë

i gjithë trupi është i shëndoshë, e nëse ajo është e sëmurë, atëherë i gjithë trupi është i sëmurë”.⁽¹⁾

Në një hadith tjetër thuhet:

“Kur besimtari bën një mëkat, në zemrën e tij shfaqet një pikë e zezë. Nëse besimtari pendohet dhe kërkon falje nga Allahu, atëherë zemra e tij pastrohet dhe kthehet në gjendjen origjinale. E nëse ai vazhdon në mëkat pika e zezë në të rritet edhe më tepër”.⁽²⁾

Ky hadith, siç edhe kuptohet, nuk flet për mëkatin e bërë nga jobesimtari, por e përshkruan atë se çfarë mund të ndodhë me zemrën kur një besimtar bën mëkat duke qenë i vetëdijshëm për veprimin e tij.

“Kjo, sepse ata fillimisht besuan, pastaj mohuan, kështu që zemrat e tyre u vulosën dhe ata nuk kuptojnë më”.

(Kuran, 63:3)

Në një pjesë tjetër të Kuranit ky fenomen është theksuar edhe më hollësisht:

“Kushdo që mohon Allahun, pas pranimit të besimit, (do të dënohet ashpër), përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim. Ndërsa ata që ia hapin zemrën mosbesimit, do të kenë mbi vete zemërimin e Allahut dhe një dënim të madh. Kjo, sepse ata e duan më shumë jetën e kësaj bote, sesa jetën e botës tjetër; Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë mohuesit. Këta janë ata të cilëve Allahu ua ka vulosur zemrat, të dëgjuarit dhe të parët; pikërisht këta janë të shkujdesurit”.

(16: 106-108)

III

Termi *nefs* (ego-vete) përcjell një tjetër koncept të ngjashëm me *ruh*-un (shpirtin) dhe *kalb*-in (zemrën); ai është një fjalë tjetër

¹ Regjistroi Buhariu.

² Regjistroi Ibni Maxheh.

e përdorur në Kuran, për të treguar një aspekt të rëndësishëm të psikikës njerëzore. *Nefs* është personi ose vetja, egoja. Kurani e ndan *nefs*-in në tri kategori:

1. *En-nefs el-ammare bi-ssui*: *nefs*-i i prirë për veprime të devijuara
2. *En-nefs el-levvameh*: *nefs*-i i prirë për qortim dhe ndryshim
3. *En-nefs el – mutmeineh*: *nefs*-i paqësor – shpirti i qetësuar, i bindur plotësisht

Efekti kryesor i *nefsul el-ammare bis-sui* është paralizimi i procesit konjuktiv. Kjo duket se është aluduar në disa pjesë të Kuranit:

“Ne kemi paracaktuar për Xhehenemin shumë xhinde dhe njerëz, sepse ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më keq. Pikërisht këta janë të shkujdesurit”.

(Kuran, 7:179)

Padëgjueshmëria ndaj vërejtjeve e qortimeve, neglizhenca dhe mosudhëzimi, janë vetëm disa nga karakteristikat e njerëzve të tillë, fati i të cilëve është përshkruar në citatin kuranor të lartpërmendur.

Në anën tjetër, *en-nefsul evvameh* është deklarim i vigjilencës konstante për ndryshime si dhe për studimin e aksioneve në luftë kundër dëshirave të tepruara. Kjo vigjilencë konstante është faza e parë e *en-nefs el-mutmeineh*. Kurani këtë term, pra “*en-nefs el-mutmeine*”, e ka përdorur vetëm atëherë kur e ka përshkruar kthimin e shpirtit të njeriut te Krijuesi i tij:

“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai i kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e mi dhe hyr në Xhenetin Tim”!

(89:27-30)

Këto tri terma të lartpërmendura, *ruh*, *kalb* dhe *nefs*, i referohen dimensionit të brendshëm të njeriut. Ato janë të ndryshme në kuptim, por të ndërlidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Sipas Ebu Hamid Gazaliut *kalb*-i (zemra) është esenca e njeriut, një entitet shpirtëror i cili qëndron në trupin fizik. Ajo kontrollon organet dhe funksionet tjera fizike të tij. Përndryshe, Gazali në gjitha

shkrimet e tij fjalën *kalb* (zemër) e përdor për veten, egon-nefsin
Njeriu është *mikrokozmos*, i cili reflekton *makrokozmosin* –
universin, i përbërë nga trupi (*xhesed*), psikika (*nefs*) dhe shpirti
(*ruh*).

Bibliografia:

- Umaruddin, M. (1951) The ethical philosophy of Al-Ghazali.
- Fazlu ur Rahman, (1975) The Philosophy of Mulla Sadra, New York.
- Muhammad Asad, The Message of the Qur`an, (Dar al-Andalus, 1980).